

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbardhen diskutimet e mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, ja 4 pikat kyçe
ADRESA	https://www.cna.al/politike/zbardhen-diskutimet-e-mbledhjes-se-keshillit-te-sigurise-kombetare-ja-4-i475402
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:28:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6de75e17830ce927beb19e7c4aa8a659af0b1753a735d4cdf497ce0699591fd4
TEKSTI	b49061e97c649011e64e06c31364687fa44d9edd8ff49c3967807d7338a7be90
PAMJA	1dea1f6cea3c935fddb8de993a03919aa267ffa5d46ee96ca81e12c6676d10a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5fa576c068e11bf15e10fdd7eed9852435d7eecb5545d6636c42491cb233c9a6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5fa576c068e11bf15e10fdd7eed9852435d7eecb5545d6636c42491cb233c9a6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Zbardhen diskutimet e mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, ja 4 pikat kyçe



28 Shtator 2026, 17:21, Politikë CNA



Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, thirri këtë të hënë mbledhjen e Këshillit të Sigurimit Kombëtar.

Ky zhvillim erdhi pas publikimeve të bujshme të bëra prej një javë për çështjen e Shërbimit Informativ Shtetëror.

Në mbledhje, përveç anëtarëve që përcakton ligji, ishin të ftuar edhe institucioni e Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-u.

Siç bëhet me dije përmes një njoftimi nga Zyra e Shtypit të Presidencës, Këshilli diskutoi për situatën dhe masat që duhet të merren nga institucionet për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, bashkëpunimin me partnerët dhe aleatët dhe forcimin e besimit të publikut.

"Në takim u konkludua se:

Për sigurinë kombëtare, institucionet nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin. Ato kanë përgjegjësi të ndryshme, por i shërbejnë të njëjtit interes: sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Çdo mosbesim institucional të zëvendësohet me bashkëpunim, koordinim dhe komunikim profesional.

Hetimet e drejtësisë të zhvillohen tërësisht të pavarura dhe të respektohen nga të gjithë. Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit dhe ndaj institucioneve të sigurisë.

Institucionet t'u tregojnë qytetarëve se sistemi di të korrigjojë vetveten e të mbrojë interesin publik. Detyra jonë është të forcojmë standardet, kontrollin, transparencën, llogaridhënien dhe bashkëpunimin institucional.

Shqipëria ka institucione, ka partnerë dhe aleatë ndërkombëtarë, ka profesionistë dhe kapacitete. Institucionet e Republikës të punojnë së bashku për të forcuar shtetin, sigurinë kombëtare dhe besimin e qytetarëve"; theksohet në njoftim./CNA



Të sugjeruara

Kundër ndarjes në 100 bashki/ Manja: Kemi ngutje, nisma e PS-së të votohet para zgjedhjeve

Këshilli Bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanit dhe Cërrikun

Debate në Komision/ Korreshi-socialistëve: Po tallni b*thën me Reformën Territoriale, doni vota

Skandali i SHISH-it/ Ish-presidenti: Produkt i mazhorancës, Rama të mbajë përgjegjësi politike

Rreth 2 orë me socialistët dhe kabinetin/ Zbardhet fokusi i takimit të Ramës

Një problematikë që prish takimin në tryezën e integritit!

"Shqipëria është në rrugë të mbarë"/ Komisionerja e BE-së, Marta Kos: Mes 4 shteteve me ecuri pozitive

DETAJET/ Skandali i SHISH-it, nesër mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare

"As dorëheqje e as zgjedhje të reja"/ Muçollari: Rama pa etikë, asnjë plan kundër krimit

Ndryshime në trupën diplomatike shqiptare në Prishtinë dhe Shkup

Këlliçi i kundërpërgjigjet Ramës: Nuk ke fytyrë të dalësh para shqiptarëve, jep dorëheqjen

Shkullaku ironizon Ramën: U varfërova nga politika, s'ka bir kve të të gjejë lekë të shqiptarëve në xhep**

Adresimi i Ramës/ Gazetari: "Lau duart" nga skandali i SHISH-it, vetë doli i ndershëm

"Bashkia Tiranë, totalisht e bllokuar"/ Alimehmeti: Telenovelë e Veliajt në kurriz të qytetarëve

Noka sulmon Ramën: I ka hyrë lepuri në bark, strumbullar i skandaleve shtetërore

Berisha udhëton në Strasburg/ Zbardhet agjenda e kryedemokratit

"Do të mbajë pushtetin me forcë"/ Këlliçi reagon për adresimin e Ramës

E PLOTË/ Fjala e Ramës drejtuar shqiptarëve, nga skandali i SHISH-it te korrupsioni dhe drejtësia

Konferenca e Ramës/ PD: Shmangie e llogaridhënies, komunikim i kontrolluar

"Askush nuk mund të më ndalë"/ Rama, drejtuar shqiptarëve: Korrupsioni, hije e rrezikshme e rrugës sonë


[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM





Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

16:23 Opinione Albana Vokshi

Nga Albana Vokshi/ Si po e mund narkoshteti shqiptar kushtëzimin evropian

14:10 Opinione Dashnor Kokonozi

Pse z. Rama mbeti një “çun Tirone” dhe nuk u bë kurrë burrë shteti?

14:06 Opinione Mitro Çela

MILIONERË NGA POLITIKA

[Lifestyle](#)

22:20 Lifestyle

Ekspertët e modës i miratojnë/ Ja 5 ngjyrat e pazakonta në trend për vjeshtën

Kur bëhet fjalë për tendencat klasike të ngjyrave që janë ...

19:00 Lifestyle

Llumi i kafesë me uthull, ja truku praktik për pastrimin e kuzhinës

Një truk praktik dhe ekonomik pastrimi përfshin përdorimin...

17:52 Lifestyle

Zbulohen 25 destinacionet më të mira për vitin 2027

Sapo kemi hyrë në vjeshtë dhe Lonely Planet është tashmë t...

14:00 Lifestyle

Ishte shtruar në klinikë rehabilitimi/ Ndërron jetë djali i modeles së njohur

Presley Gerber, djali i supermodeles Cindy Crawford, ka nd...

trending

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.